



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-4959/17

Dt. 12.05.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Elver (Zhut) Gashi** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet P+1, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM



I. I LEJOHET: aplikuesit: **Elver (Zhut) Gashi** nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim - objekt i banimit individual, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin ekzistues Urbanistik "Dardania Lindore" dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351-48533, të datës 14.12.2016, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me nr. 418/0, Z.K. Jahoc, në rrugën "Lekë Dukagjini", në pronësi të lartë përmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+1, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit **S=254.16 m²**.

Përdhesa: (Sip,Bruto): **S= 124.65 m²**

Kati i parë: (Sip,Bruto): **S= 129.51 m²**

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të banimit individual, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese "Real – PROJECT" Gjakovë.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

V. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Elver (Zhut) Gashi nga Gjakova, me banim në rrugën “Lek Dukagjini” pn, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-4959/17 të datës 09.03.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet P+1, në ngastrën kadastrale me nr. 418/0, Z.K. Jahoc, në rrugën “Lekë Dukagjini”, siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 08.12.2016, të punuar nga NPSH“GELI- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 03.11.2016 në pronësi të Elver (Zhut) Gashi, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikaten mbi të drejtat në pronën e paluajtshme me nr. të lëndës 6829/16, të datës 27.12.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore, me nr. 07-351-48533, të datës 14.12.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të banimit individual, në ngastrën kadastrale me nr. 418/0, ZK: Jahoc, të lëshuar nga DUMM.
5. Autorizimin Noterial, me nr.LRP.Nr.9450/2016, dt.04.11.2016.
6. Deklaratën Noteriale me nr. LRP.Nr.6427/2016, dt.28.12.2016.
7. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr.08-320-01-4565, dt.06.03.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
8. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-B-548 të datës 28.12.2017.
9. Pëlqimin nga KEDS - Gjakovë, të datës 03.03.2017.
10. Pëlqimin nga K.R.U.”Radoniqi”Sh.A.Gjakovë, nr. 5030, dt.29.12.2016.
11. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, dt. 20.12.2016.
12. Vërtetimin nga K.R.M.”Çabrati”, nr.108, dt.10.02.2017.
13. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Postën e Kosovës, filiala Gjakovë me datë 10.05.2017.
14. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, ndërmarrja projektuese “Real – PROJECT” Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 1183.76 Euro.


KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.


Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspekcionit,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani, jur.dipl.

U.D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : GJAKOVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : JAHOC



Shkalla / Razmera /Scale: 1:500

Punoi \ Obradio \ Created :

Data \ Data \ Date : 03.11.2016

Koha \ Vreme \ Time : 14:45:17

Nënshkrimi \ Potpis \ Signature:

Shënim \ Beleška \ Note :

Aprovoi \ Usvojio \ Aproved : Drejtori \ Direktor \ Director

Nënshkrimi \ Potpis \ Signature:

